

LLOGARITË E FLUKSEVE TË MATERIALEVE MJEDISORE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
5.1 Periudha e referencës	6
6. Mandati institucional.....	6
7. Konfidencialiteti	6
8. Politika e botimit.....	7
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	8
11. Manaxhimi i cilësisë	9
12. Rëndësia.....	9
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave.....	11
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komentet.....	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
1.3. Personi i kontaktit	Etis Jareci
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ejareci@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	23.04.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	23.04.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	23.04.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është një nga modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare. Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore kanë për objektiv kryesor të përshkruajnë lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ato përfshijnë sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim. Llogaritë Ekonomike Mjedisore (LL.E.M) japin një pasqyrim, prej mijëra ton në vit, të rrjedhshmërisë së materialeve brenda dhe jashtë ekonomisë. Llogaritë

	Ekonomike Mjedisore mbulojnë materiale të ngurta, të gazta dhe të lëngshme, me përjashtim të flukseve të mëdha të ujit dhe ajrit. Ashtu si sistemi kombëtar i llogarive, Llogaritë Ekonomike Mjedisore janë një sistem informacioni multi funksional. Flukset materiale të detajuara sigurojnë një databazë të pasur empirike për qëllime të shumta analitike. Më tej Llogaritë Ekonomike Mjedisore janë përdorur për të ndarë indikatorë të ndryshëm të flukseve materiale. Instituti Kombëtar i Statistikave i dërgon Eurostat në bazë vjetore Llogaritë Ekonomike Mjedisore. Llogaritë përfshijnë tabelat e mëposhtme të raportimit: • Tabela A “Nxjerrja e brendshme”: regjistron flukset materiale nga mjedisi në ekonomi në një ndarje të detajuar sipas llojit të materialit; • Tabela B “Importet”: importet totale (brenda dhe jashtë BE-së). Këto tabela fizike të tregtisë regjistrojnë importet e produkteve në mijë ton dhe të grupuara sipas materialeve; • Tabela D “Eksportet”: eksportet totale (brenda dhe jashtë BE-së). Këto tabela fizike të tregtisë regjistrojnë eksportet e produkteve në mijë ton dhe të grupuara sipas materialeve; • Tabela F “Prodhimi i brendshëm i përpunuar”: regjistron flukset materiale nga ekonomia në mjedisin e brendshëm (p.sh. emetimet në ajër, ujë dhe tokë); • Tabela G “Artikujt balancues”: raporton disa artikuj memorandumë të cilët janë të nevojshëm për të pasur një ekuilibër të plotë material në lidhje me një ekonomi kombëtare; • Tabela H “Treguesit”: paraqet treguesit e nxjerrë nga llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore të cilët llogariten automatikisht nga Tabela A deri në G; • Tabela I “Llogaritë e Flukseve së Materialit në ekuivalentët e lëndës së parë”: regjistron llogaritë e flukseve së materialit në ekuivalentët e lëndës së parë. Disa artikuj llogariten automatikisht bazuar në të dhënat e raportuara në Tabelën A dhe Tabelën I.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Llogaritë Ekonomike të Mjedisit regjistrojnë flukset fizike të materialeve të ndara sipas llojit të rrjedhës dhe llojit të materialit. Lloji i dimensionit të flukseve korrespondon me tabelat e raportimit të pyetësorit të Llogarive Ekonomike Mjedisore dhe treguesit e nxjerrë, përkatësisht: • Nxjerrja e brendshme (Tabela A); • Importet fizike (Tabela B); • Eksportet fizike (Tabela D); • Prodhimi i brendshëm i përpunuar (Tabela F); • Artikujt e balancimit (Tabela G); • Hyrja e drejtpërdrejtë e materialit (tregues); • Konsumi i brendshëm i materialit (tregues); • Bilanci tregtar fizik (tregues).

	Ndarja sipas llojit të materialit përdor një klasifikim të materialeve. Ky klasifikim i materialeve Llogarite Ekonomike të Mjedisit është hierarkik me kategoritë kryesore të flukseve së materialit (niveli 1-shifror). Secila kategori kryesore ndahet më tej, maksimalisht në nivelin 4-shifror: 1-Shifror: kategoria e materialit; 2-Shifror: klasa e materialit; 3-Shifror: grupi i materialit; 4-Shifror: nëngrupi i materialit.
3.3. Mbulimi i sektorit	Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore japin informacion statistikor mbi: 1. Burimet e brendshme natyrore; 2. Importet e materialeve mjedisore; 3. Eksportet e materialeve mjedisore; 4. Përdorimin e brendshëm të materialeve mjedisore. Të dhënat u referohen ekonomive kombëtare siç përcaktohet në sistemin e llogarive kombëtare.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Disa nga kategoritë kryesore dhe indikatorët kryesorë të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore janë: Biomasa: Biomasa përfshin materialet organike jo fosile me origjinë biologjike. Sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore, lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin të gjithë produktet bujqësore, peshqit dhe kafshët e gjetisë. Blegtoria dhe produktet blegtorale (si p.sh qumështi, mishi, vezët) nuk përfshihen në këtë kategori. Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike: Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike të përpunuara dhe të pa përpunuara janë dy grupe kryesore në kategoritë e materialeve mjedisore, sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore, që përbëhen nga prodhimet e minierave, industria e ndërtimit dhe mineralet industriale. Materialet fosile të energjisë: Përfshijnë burimet e naftës dhe materialet e tjera fosile të energjisë që janë formuara në të kaluarën gjeologjike, nga biomasa. Ato përfshijnë lëndet e ngurta, lëngjet dhe gazet. Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore: Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin sasinë vjetore të lëndëve të para (me përjashtim të ujit dhe ajrit) të nxjerra nga mjedisi natyror për t'u përdorur në ekonomi, për qëllime ekonomike. Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore: Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat shumën vjetore të lëndëve të para të nxjerra dhe të përdorura në ekonominë kombëtare, plus të gjitha importet fizike, minus të gjitha eksportet fizike. Bilanci fizik tregtar: Bilanci fizik tregtar është i barabartë me importet fizike minus eksportet fizike. Varësia nga importi i materialeve (VI): llogaritet si raport i importeve mbi

	inputet direkte të materialeve (IDM), në përqindje. Termi “varësia nga importet e materialeve” tregon shkallën në të cilën një ekonomi mbështetet në importe për të përmbushur nevojat e saj për materiale. Varësia nga importet e materialeve nuk mund të jetë negative ose më e lartë se 100%. Vlerat e barabarta me 100% tregojnë se nuk ka patur nxjerrje nga burimet e brendshme natyrore gjatë vitit të referimit. $VI = \frac{Importe}{(Burimet\ e\ brendshme + Importe)}$ Produktiviteti i burimeve përcakton një tregues që pasqyron PBB-në e gjeneruar për njësi të burimeve të përdorura nga ekonomia. Konceptualisht, Llogaritë Ekonomike të Mjedisit i përkasin sistemit ndërkombëtar të kontabilitetit ekonomik mjedisor (Sistemi i Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik). Për më tepër, Llogaritë Ekonomike Mjedisore janë një nga disa module fizikë të programit të Eurostat për llogaritë ekonomike mjedisore evropiane. Ajo është e mbuluar nga Rregullorja (BE) Nr. 691/2011 mbi llogaritë ekonomike mjedisore Evropiane. Llogaritë Ekonomike Mjedisore janë të lidhura ngushtë me konceptet dhe përkufizimet e llogarive kombëtare. Më së shumti, ata ndjekin parimin e qëndrimit, d.m.th. regjistrojnë flukse materiale në lidhje me aktivitetet e njësisë rezidente, pavarësisht se ku ndodhin gjeografikisht. Udhëzime të mëtejshme metodologjike janë dhënë në botime të ndryshme nga Eurostat (shih faqen e internetit të Eurostat > Mjedisi > Metodologjia, titulli: “Flukset materiale dhe produktiviteti i burimeve”).
3.5. Njësia statistikore	Njësitë statistikore ndryshojnë sipas burimeve të ndryshme të të dhënave (p.sh. bujqësia, pyjet dhe statistikën e peshkimit, statistikën e prodhimit, vrojtimet gjeologjike, statistikën e energjisë, statistikën e tregtisë së jashtme etj.) Në të cilat bazohen Llogaritë Ekonomike Mjedisore.
3.6. Popullata statistikore	Llogaritë Ekonomike Mjedisore i referohet të gjithë ekonomisë kombëtare të vendit raportues. Llogaritë Ekonomike Mjedisore përfshin të gjitha materialet (me përjashtim të ujit dhe ajrit) që kalojnë kufirin e sistemit (midis mjedisit dhe ekonomisë) në anën e hyrjes ose në anën e prodhimit. Ekonomia përcaktohet nga konventat e sistemit kombëtar të kontabilitetit (njësitë rezidente). Të dhënat materiale në ekonomi mbulojnë nxjerrjen e burimeve natyrore (duke përjashtuar ujin dhe ajrin) nga mjedisi natyror dhe importet e produkteve materiale (të mira) nga pjesa tjetër e ekonomisë botërore. Daljet e materialit janë depozitimet e materialeve në mjedisin natyror dhe eksportet e produkteve materiale dhe mbetjeve në pjesën tjetër të botës. Informacioni mbi burimet natyrore të nxjerra dhe produktet e tregtuara sigurohet nga njësi të ndryshme statistikore.
3.7. Zona e referencës	Statistikat mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore mbulojnë gjithë

	territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2010 dhe në vazhdim për: • Burimet e brendshme natyrore; • Importet dhe eksportet sipas kategorive të materialeve mjedisore; • Përdorimin e brendshëm të materialeve mjedisore.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Njësia matëse është mijë ton.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha e referencës për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është 31 Dhjetor 2023. Ky raport i referohet vitit 2023.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në të cilin bazohen Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore konsiston në: • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026; Baza ligjore përkatëse në nivel Evropian konsiston në : • Regulloren (EU) 691/2011; • Sistemi i Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik; • Methodologjia mbi "Flukset materiale dhe produktiviteti i burimeve".
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore transmetohen në Eurostat nëpërmjet platformës EDAMIS. Nuk është i zbatueshëm në nivel kombëtar, ky informacion kërkohet vetëm në nivel evropian.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i Ligjit për Statistikat Zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është

	konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore. Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura në njësinë statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna publikohen së bashku dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, përfshirë vendimet për kontrollin fiskal ose hetimet ligjore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet për shpërndarjen e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para- shpallur në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të

	mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individi për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Të dhënat në formë table; 4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat e Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore publikohen në baza vjetore.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacione mbi treguesit kryesorë si: biomasa, mineralet metalike dhe jometalike, materialet fosile të energjisë, etj. Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore janë botuar në faqen e internetit të INSTAT nën temën: • Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni më poshtë: Databaza .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Baza e të dhënave në nivel mikro nuk publikohet për arsye konfidencialiteti. Të dhënat e agreguara janë lloji i vetëm i të dhënave që u jepet përdoruesve të jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk janë publikuar, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore.

	Metodologjia e Llogarive të Flukseve së Materialeve në Ekonomi është e bazuar në manualët dhe rregulloret e Eurostat, i cili përmban një grup të plotë rekomandimesh për përpilimin e treguesve të statistikave të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore në Ekonomi.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Llogarive Ekonomike për Bujqësinë dhe Mjedisin dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi statistikën e Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Llogarive të Flukseve së Materialeve Mjedisore në Ekonomi krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore janë: • Institucionet e administratës publike; • Universitetet; • Organizata jofitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Studiuesit, studentët dhe grupe të tjera të ngjashme.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve . Rezultatet e vërtetimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës " Llogaritë Ekonomike të Mjedisit " është vlerësuar me 3.80 pikë (76 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave mbi "Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore në

	Ekonomi” gjykohe duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave të “Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore në Ekonomi” për 2023 do të llogaritet nga EUROSTAT.								
13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton institucionet përkatëse dhe sektorët brenda INSTAT për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm. Të dhënat janë përpiluar nga një gamë e gjerë e burimeve të të dhënave (p.sh. bujqësia, pyjet dhe statistikat e peshkimit, statistikat e prodhimit, vërtetimet gjeologjike, statistikat e energjisë, statistikat e tregtisë së jashtme etj.). Saktësia e përgjithshme konsiderohet e mirë.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Statistikave për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore publikohen në faqen e internetit të INSTAT 479 ditë kalendarike pas përfundimit të periudhës referuese (T + 479 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është data 31 Dhjetor 2023. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>4/23/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>479</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	4/23/2025	Afatet kohore	479		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	4/23/2025								
Afatet kohore	479								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore publikohen në kalendarin e publikimeve. Publikimi për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>4/23/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>4/23/2025</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	4/23/2025	Data e publikimit	4/23/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e shpallur	4/23/2025								
Data e publikimit	4/23/2025								
Vonesa në kohë	0								

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore përpilohen në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Eurostat dhe janë të krahasueshme me të gjithë vendet europiane që raportojnë të dhënat e Llogarive Ekonomike Mjedisore në Eurostat.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Të dhënat mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore datojnë që nga viti 2010 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 14 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=14$). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Nuk aplikohet.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi të përfshirë në përgatitjen e statistikave mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është: 2 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, në sektorin e Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve;
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se autoritetet lokale që dërgojnë informacion në INSTAT mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore do të raportojnë ndryshime, ky informacion do të azhurnohet dhe publikohet në botimin e muajit pasardhës, shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime mbi “Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore” për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Për statistikën mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore, INSTAT përdor informacionin e siguruar nga: • Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR),

	• Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), • Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), • Vrojtime të ndryshme statistikore të realizuara në INSTAT.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore mbledhen në baza vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore janë të dhëna administrative. Informacionin statistikor i Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore grumbullohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), si edhe nga sektorët brenda Institutit të Statistikave (INSTAT).
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Mbulimi është gjithëpërfshirës në nivel vendi, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor është gjithmonë i disponueshëm, kështu që vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	